

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN
02 Pal. / Nr. 1012/19
Nr. llog. / B. sh. - 02 -
Datat / Datum: 19.08.2019
MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Palët Nënshkruese,

- 3 Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga **z. Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës,
- 4 Kompania "Haxha Company" SHPK., përfaqësuar nga **z. Haxhi Zejnullahi**, nr. biznesit 71027066, pronar - shfrytëzues i Gurores në fsh. Tërllabuq, Komuna e Vushtrrisë.

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është mirëmbajtja – shtruarja me asfalt e rrugëve lokale nga ana e kompanisë "Haxha Company" SHPK. e cila e shfrytëzon guroren në fshatin Tërllabuq, në njësinë kadastrale nr.748-0, ZK-le Tërllabuq, duke filluar nga Gurorja – Gurëthyesi deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri – Mitrovicë, të cilat janë dëmtuar apo dëmtohen gjatë transportit të materialit guror.

Neni 2
Obligimet – Përgjegjësitë

2.1 Obligimet e përbashkëta të palëve të marrëveshjes:

- 2.1.1 Identifikimi i dëmtimeve të rrugëve lokale nëpër të cilat bëhet bartja e materialit gurorë nga gurorja – gurëthyesi në fshatin Tërllabuq deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri – Mitrovicë.
- 2.1.2 Mbikëqyrja e përbashkët në baza mujore e gjendjes së rrugës për sa i përket dëmtimeve eventuale me rastin e transportit të materialit gurorë nga vend punishtja (gurorja) deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri – Mitrovicë dhe raportimi në komunë për dëmtimet e shkaktuara.

2.2 Obligimet e Kompanisë "Haxha Company" SHPK,

- 2.2.1 Mirëmbajtja – asfaltimi i rrugëve lokale të dëmtuara apo dëmtohen nëpër të cilat bëhet bartja e materialit gurorë nga gurëthyesi deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri Mitrovicë.
- 2.2.2 Raportimi në komunë për punët e kryera rreth mirëmbajtjes së rrugëve të cekur në pikën paraprake.

2.3 Obligimet e komunës së Vushtrrisë,

- 2.3.1 Të zgjedhë - eliminojë pengesat eventuale nga banorët e fshatrave nëpër të cilat bëhet bartja e materialit guror, për sa i përket identifikimit të kufijve të rrugëve lokale që janë objekt i kësaj marrëveshje me rastin e kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes – asfaltimit.
- 2.3.2 Përmes zyrtarit të komunës, përcjellja e zbatimit të kësaj marrëveshje dhe raportimi te kryetari i komunës.

Neni 3.

Mbikëqyrja – Pranimi i punëve,

3.1 Në emër të K. së Vushtrrisë: Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve: Nexhat Merovci, Menaxher i zyrës së projekteve të komunës, Ramiz Maliqi, Zyrtar për leje ndërtimore dhe Isa Latifi, gjeodet.

3.2 Në emër të Kompanisë “Haxha Company” SHPK, përfaqësuesi i autorizuar i saj.

Neni 4.

Kohëzgjatja

4.1 Kjo marrëveshje lidhet për periudhën kohore, nga dita e nënshkrimit deri në përfundim të afatit të licencës së kompanisë “Haxha Company” SHPK për shfrytëzim të gurores në fsh. Tërllabuq.

4.2 Kompania “Haxha Company” SHPK do të njoftoj Komunën e Vushtrrisë për datën e përfundimit të afatit të licencës për shfrytëzim të gurores përkatësisht përfundimin e shfrytëzimit të gurores e cila është objekt i kësaj marrëveshje.

Neni 5.

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i marrëveshjes

5.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.

5.2 Brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese, përmes përfaqësuesve të tyre do të marrin masa në kuptim të nenit dy (2) të kësaj marrëveshje.

Vushtrri, më 19/08 2019

“Haxha Company” SHPK

Z. Haxhi Zejnullahi, Drejtor



Komuna Vushtrri

Z. Xhafer Tahiri, Kryetar